



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës  
Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

---

## **BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE**

**Nëntor, 2025**

## PËRMBAJTJA E BULETINIT

1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë muajit nëntor 2025
2. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave
3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
4. Epidemitë e lajmëruara
5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
6. COVID-19
7. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

### QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

### 1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT NËNTOR 2025

Gjatë muajit nëntor 2025 janë raportuar 12,643 raste me sëmundje ngjitëse Inc.(709.44 raste /100, 000 banorë). Ky numër i rasteve është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 (18,118 raste apo Inc 1,016.66 raste/100,000). Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: Influenca sezonale (ILI) me 6,336 raste ose Inc. 355.53/100,000, Diare ac. me 3,894 raste ose Inc. 218.5/100,000 banorë dhe ARI/ITPR me 1,450 raste ose 81.36 në 100,000 banorë (Tab.1).

Gjatë muajit nëntor 2025 janë raportuar 4 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 2 raste me dg. Infiltratio Pulmonum me diagnozë përcjellëse dhe 2 raste me dg. Bronchopneumonia me diagnozë përcjellëse.

**Tabela 1. Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/ shkaktarëve të raportuara në Kosovë, nëntor 2025 krahasuar me nëntor 2024**

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Kosovë				
01 - 30 nëntor të vitit 2025 dhe 2024				
Sëmundjet/shkaktarët	Nëntor, 2024		Nëntor, 2025	
	Nr.	Incidenca/ 100,000	Nr.	Incidenca/ 100,000
COVID-19	7	0.39	3	0.17
ITPR - Pneumonia/ARI	1739	97.58	1450	81.36
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	24	1.35	25	1.40
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	10887	610.90	6336	355.53
Influenca A	5	0.28	31	1.74
Influenca B	1	0.06		0.00
RSV	23	1.29	55	3.09
Diarea acute	4726	265.19	3894	218.50
Variçela	519	29.12	537	30.13
Sindromi meningjeal	7	0.39	22	1.23
EHSV	1	0.06		0.00
Helmimet me ushqim	45	2.53	55	3.09
Infeksionet tjera bakteriale me ushqim		0.00		0.00
Infeksionet virale intestinale dhe ato me rotavirus	6	0.34	5	0.28
Salmonella enteritidis	5	0.28		0.00
Shigelloza		0.00		0.00
Adenovirus		0.00	1	0.06
Enterovirus		0.00	1	0.06
Gastroenterokolitet	28	1.57	64	3.59
Hepatiti akut B	8	0.45		0.00
Hepatiti akut C		0.00		0.00
Campylobacter	1	0.06		0.00
Parotiti epidemik	1	0.06	1	0.06
Pertussis	8	0.45	4	0.22
Tularemia	1	0.06	1	0.06
Brucelosis	1	0.06		0.00
Leishmaniazë		0.00	1	0.06
Sëmundja Lyme		0.00	1	0.06
HIV/AIDS	3	0.17	3	0.17
IST	31	1.74	29	1.63
TB	19	1.07	26	1.46
Cl.difficile			2	
Giardiaza		0.00	7	0.39
Infeksionet streptokoksike të grupit A	13		20	
*Sëmundjet tjera ngjitëse	9	0.51	69	3.87
<b>Gjithsej</b>	<b>18118</b>	<b>1016.66</b>	<b>12643</b>	<b>709.44</b>
<b>*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza</b>				

## 1. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË, NËNTOR 2025

### Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën e agreguar

**Influenca sezonale /ILI:** Gjatë muajit nëntor 2025 në IKSHPK janë raportuar 6,336 raste me ILI (Inc. 355.53/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet rënie prej 41.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (10,887 raste) por krahasuar me muajin paraprak, tetor 2025 me (5,639 raste të raportuara me ILI) rritje prej 12.36%. Kjo rritje mund t'i atribuohet disa faktorëve, përfshirë uljen sezonale të temperaturave, rritjen e qëndrimit në ambiente të mbyllura, shtimin e kontakteve ndërpersonale, si dhe qarkullimin e shtuar të viruseve respiratore, përfshirë virusin e gripit dhe viruset e tjera respiratore.

**Diarea akute:** Gjatë muajit nëntor 2025 në IKSHPK janë raportuar 3,894 raste me diare akute (Inc.218.50/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (4,726 raste), vërehet një ulje prej 17.6% dhe gjithashtu krahasuar me muajin tetor 2025, me 5,276 raste të raportuara, ulje prej 26.2% e rasteve të raportuara. Megjithatë, pavarësisht rënies, numri i rasteve të raportuara mbetet shqetësues për shëndetin publik, marrë prasysh ekspozimin e vazhdueshëm të popullatës ndaj patogjenëve të ndryshëm ushqimorë dhe atyre përmes ujit, veçanërisht kushtet e ruajtjes dhe përgatitjes së ushqimit.

**ARI/ITPR:** Gjatë muajit nëntor 2025 në IKSHPK janë raportuar 1,450 raste me ARI (Inc.81.36/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (1,739 raste) vërehet ulje prej 16.6 % e numrit të rasteve të raportuara por krahasuar me muajin paraprak tetor 2025 me (1,021 raste), rritje prej 42.01%. Kjo rritje lidhet kryesisht me fillimin e sezonit të infeksioneve respiratore, uljen e temperaturave, si dhe rritjen e ekspozimit në ambiente të mbyllura, duke favorizuar përhapjen e patogjenëve respiratorë.

**Variçella:** Gjatë muajit nëntor 2025 në IKSHPK janë raportuar 537 raste me Variçellë (Inc.30.13/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (519 raste) vërehet rritje minimale prej 3.46% por krahasuar me muajin paraprak tetor 2025 me 456 raste të raportuara, rritje prej 17.76% e numrit të rasteve të raportuara. Rritja e rasteve mund të lidhet me qarkullimin sezonal të virusit të variçellës, si dhe me rritjen e kontakteve veçanërisht në ambientet shkollore dhe parashkollore.

### Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën individuale:

#### Sëmundjet vaksinëparandaluese

Gjatë muajit nëntor 2025, në laboratorin e Mikrobiologjisë- IKShPK nga të gjitha mostrat e testuara si të dyshimta në fruth, parotit, pertussis dhe rubellë janë konfirmuar 4 raste pozitive me Pertussis. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është raportuar edhe një rast me Parotit (rast i dyshimtë). Rastet e konfirmuara me Pertussis sipas komunave: Pejë -2 raste, Prishtinë dhe Mitrovicë me nga 1 rast. Sipas grup-moshës : 0-4 vjeç (2 raste), 5-9 dhe 15-19 vjeç me nga 1 rast. Vetëm njëri nga rastet pozitive ka status vaksinat të kompletuar për moshën, që tregon rëndësinë e mbulimit të plotë me vaksinim me qëllim të parandalimit të sëmundjes.

## Zoonozat dhe sëmundjet transmise

Gjatë muajit nëntor 2025, në Laboratorin e Mikrobiologjisë të IKSHPK-së, nga mostrat e testuara si të dyshimta për Brucelozë, Tularemi, Leptospirozë dhe Toksoplazmozë është raportuar 1 rast pozitiv me Tularemi.

Rasti pozitiv me Tularemi është raportuar nga fshati Dobroshec, komuna e Drenasit, i përket gjinisë femërore, grupmoshës 10–19 vjeç.

Pas anketimit epidemiologjik dhe realizimit të vizitës në terren në fshatin Dobroshec janë identifikuar ruajtje jo adekuate e ushqimeve në depo, mungesë e masave mbrojtëse ndaj brejtësve dhe insekteve, si dhe kushte të pasigurta për furnizimin me ujë. Si rrjedhojë e këtyre faktorëve, rreziku për kontaminim është vlerësuar i lartë. Janë dhënë rekomandimet për ngritje të vetëdijes, rëndësinë e higjienës personale dhe ushqimore si dhe për masat parandaluese ndaj sëmundjeve zoonotike.

## Sindroma meningjeale

Gjatë muajit nëntor, 2025 janë raportuar 22 raste me Sindromë Meningjeale (Inc. 0.23/100 000 banorë), prej tyre 17 raste me Meningjit akut viral dhe 5 raste me Meningjit bakterial. Ky numër i rasteve të raportuara është më i lartë krahasuar me periudhën e vitit 2024, ku ishin të raportuara gjithsej 7 raste.

Sipas komunave, janë raportuar 7 raste në komunën Prishtinës, me nga 2 raste në komunën e Ferizajit, Podujevës dhe Klinës, kurse me nga 1 rast komunat: Gjilan, Mitrovicë, Fushë Kosovë, Kaçanik, Vushtrri, Istog, Deçan, Drenas dhe Viti, kurse Incidenca më e lartë e rasteve në 100,000 banorë është raportuar nga komuna e Klinës me 5/100,000 banorë.

Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezultojnë se numri më i madh i rasteve i takon grup- moshës 0-9 vjeç me 59% (13 raste), grup moshat: 70-79 vjeç me 18% (4 raste), grup moshat: 10-19 vjeç me 9% (2 raste), grup moshat: 20-29 vjeç, 50-59 vjeç, 60-69 vjeç me nga 4.5% (1 rast), kurse grupmoshat 30-39 vjeç dhe 40-49 vjeç me asnjë rast të raportuar. Sipas gjinisë, rezultojnë se 54.5 % (12 raste) i takojnë gjinisë mashkullore dhe të gjinia femërore me 45.4 % (10 raste).

Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe laboratorin mikrobiologjik në Klinikën Infektive, janë izoluar 12 shkaktarë në LCS, prej tyre: 5 raste me HHV7, 2 raste me Streptococcus pneumoniae kurse me nga 1 rast Neisseria meningitidis, Varicela Zoster Virus, Epstein Barr Virus, Human Parvovirus B19 dhe Human parechovirusis.

## Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim

Gjatë muajit nëntor 2025, përmes SMSN nga të gjitha regjionet janë raportuar gjithsej 947 raste të sëmundjeve që barten me ujë dhe ushqim, prej të cilave: 874 raste me dg. Diarea dhe gastroenteritet me origjinë infektive të supozuar (A09); 10 raste me dg. Infeksionet tjera intestinale bakteriale me shkaktarë të paspecificuar (A04.8) ; 41 raste me dg. Intoksikacionet tjera bakteriale alimentare - A05; 5 raste me dg. Intoksikacionet tjera alimentare bakteriale (A04.9); 6 raste me dg. Giardiasis (Giardia lamblia) (A07.1).

Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKSHPK dhe Kl. Infektive, janë raportuar: 5 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë: 2 raste Rahovec, nga 1 rast Prizren, Kaçanik dhe Gjakovë. Sipas grup moshave: 5 raste janë të grup moshës 0-9 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 4 raste janë të gjinisë femërore dhe 1 rast i gjinisë mashkullore. 6 raste me Giardia lamblia, prej të cilave sipas komunave janë: 4 raste Gjakovë, 1 rast Pejë dhe 1 rast Prizren. Sipas grup moshave: 3 raste janë të grup moshës 0-9 vjeç dhe 3 raste të grup moshës 10-19 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 4 raste të gjinisë mashkullore dhe 2 raste të gjinisë femërore. 1 rast me Adenovirus, nga komuna e Fushë Kosovës. Rasti i takon gjinisë mashkullore dhe grup moshës 0-9 vjeç, 1 rast me Enterovirus, nga komuna e Kaçanikut. Rasti i është i gjinisë mashkullore dhe grup moshës 0-9 vjeç. 2 raste me Clostridium difficile, 1 rast nga komuna e Prishtinës dhe 1 nga komuna e Gjakovës. Rastet i përkasin gjinisë mashkullore dhe grup moshave 0-9 vjeç dhe 40-49 vjeç.

Sëmundjet që barten përmes vektorëve Gjatë muajit nëntor janë raportuar: 1 rast me Borreliozë, nga komuna e Prishtinës. Rasti i takon gjinisë mashkullore dhe grup moshës 0-9 vjeç. Rasti i raportuar i përket një fëmije mashkull, të lindur në vitin 2021, banor i Prishtinës dhe frekuentues i kopshtit “xx”. Rasti është evidentuar dhe raportuar më datë 27.11.2025.

Duke marrë parasysh karakteristikat endemike të kësaj zone për rriqra, dyshohet se infektimi ka ndodhur si pasojë e pickimit nga rriqra gjatë qëndrimit në natyrë. Nuk raportohet për ekspozime të tjera të rëndësishme apo për udhëtime jashtë vendit. Nuk ka të dhëna për raste të tjera të ngjashme të lidhura në kohë dhe vend. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është raportuar 1 rast me Leishmania, komuna e Prizrenit, me gjini femërore dhe grup moshë 10-19 vjeç.

## **Sëmundjet/Infeksionet respiratore**

Gjatë muajit nëntor 2025, janë testuar 322 mostra të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respirator dhe SARS-CoV-2, të përzgjedhura nga qendrat sentinel. Nga mostrat e testuara janë konfirmuar 31 raste me Influcencë A apo pozitivitet prej 23.56%. Rastet pozitive/të konfirmuara në Influcencë A, sipas komunave: Prishtinë (11 raste), Mitrovicë (10 raste), Skenderaj (2 raste) dhe me nga një rast komunat : Dragash, Gjakovë, Malishevë, Vushtrri, Deçan, Kaçanik, Klinë dhe Prizren. Sipas grupmoshës: 13 prej tyre i përkasin grup-moshës 0-4 vjeç, 13 raste nga grup moshë 5-14 vjeç, 3 raste nga grup moshë 15-34 vjeç dhe 2 raste nga grup moshë 35-50 vjeç.

Nga patogjenët tjerë respiratorë janë raportuar 55 (17%) mostra pozitive me RSV, 60 (18.6%) mostra pozitive në Human Rhinovirus, 34 (10.55%) mostra pozitive në Human Adenovirus, 9 (2.7%) mostra pozitive në Parainfluenca Virus dhe 7 (2.17%) mostra pozitive në Metapneumovirus. Rastet pozitive në virusin sincicial (RSV) sipas komunave dhe grupmoshës : Prishtinë (20 raste), Ferizaj (7 raste), Fushë Kosovë (6 raste), Lipjan (3 raste), Obiliq (2 raste), Podujevë (2 raste), Prizren (2 raste), Rahovec (2 raste), Viti (2 raste) dhe me një rast komunat: Gjakovë, Gjilan, Istog, Kaçanik, Klinë, Mitrovicë, Pejë, Malishevë, dhe Vushtrri. Sipas grup-moshës, 52 raste i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç dhe 3 raste grup-moshës 5-14 vjeç.

Mbikëqyrja me Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë vazhdon sipas rekomandimeve të ECDC, WHO për sezonën 2025/2026 si dhe Buletinin javor për Influcencë me të dhënat e përditësuara nga mbikëqyrja epidemiologjike dhe virologjike.

Intensiteti i Influcencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për muajin nëntor 2025 paraqitet në aktivitetin e ulët të qarkullimit megjithëse është vërejtur një rritje e dukshme e numrit të rasteve pozitive krahasuar me muajin paraprak. Impakti në shërbimet shëndetësore mbetet i ulët, ndërsa modeli i përhapjes klasifikohet si regional, pasi rastet e konfirmuara i përkasin disa komunave dhe rajoneve të ndryshme, duke reflektuar qarkullimin sezonal të virusit të Influcencës A për këtë sezonë.

Gjatë muajit nëntor 2025, përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjithëse (SMSN) dhe qendrave sentinel u raportuan gjithsej 25 raste me SARI. (Inc.1.4/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (24 raste) vërehet numër afërsisht i njëjtë i rasteve të raportuara por krahasuar me muajin paraprak (11 raste), vërehet një dyfishim i numrit të rasteve. Të gjitha rastet sipas protokollit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influcencë dhe RSV. Prej tyre u konfirmuan, 1 mostër pozitive në SARS-CoV-2, 1 mostër pozitive në Human Adenovirus, 1 mostër pozitive në Human Rhinovirus dhe 1 mostër pozitive në Metapneumovirus.

Rastet SARI sipas komunave janë: Prishtinë (9 raste), Fushë Kosovë (3 raste), Ferizaj (2 raste), Lipjan (2 raste), Klinë (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Obiliq, Mitrovicë, Drenas, Malishevë, Rahovec, Podujevë dhe Vushtrri.

Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është : mbi 65 vjeç (10 raste), 0-4 vjeç (5 raste), 15-34 (4 raste), 35-50 vjeç (3 raste), 5-14 vjeç (2 raste) dhe 51-64 vjeç (1 rast). Sipas gjinisë, 18 prej tyre i takojnë gjinisë mashkullore dhe 7 gjinisë femërore.

Në SMSN, gjatë muajit nëntor 2025, janë raportuar 26 raste me Tuberkuloz apo 1.45 në 100,000 banorë. Sipas komunave: Prishtinë (8 raste), Ferizaj (6 raste), me nga (2 raste) komunat: Kaçanik, Drenas dhe Pejë, kurse komunat si: Fushë Kosovë,

Lipjani, Klinë, Malishevë, Viti dhe Shtime me nga (1 rast). Prej 26 rasteve të raportuara, 22 (84.6%) janë raste pulmonare dhe forma ekstrapulmonare 4 (15.3%). Nga forma pulmonare, të konfirmuara bakteriologjikisht janë 11 raste (50%). Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se grup- moshë më e prekur është ajo 60-69 vjeç me 8 raste, 70-79 vjeç (6 raste), 30-39 vjeç dhe 50-59 vjeç me nga (3 raste), me 5 raste, grup moshë 40-49 vjeç (2 raste), kurse grup moshat 0-5 vjeç, 15-19 vjeç dhe 20-29 vjeç dhe 80-89 vjeç me nga 1 rast dhe grupmosha 05-14 vjeç asnjë rast. Sipas gjinisë, rezulton se gjinia mashkullore me 57.6% (15 raste) kurse 42.3% (11 raste) i takojnë gjinisë femërore.

### **Rastet me HIV/AIDS/IST**

Gjatë muajit nëntor 2025, janë raportuar 3 raste me HIV dhe një rast i vdekjes si pasojë e AIDS-it (rasti për herë të parë është diagnostikuar me HIV në vitin 2013, është i gjinisë mashkullore, grup moshë 45-54 vjeç, komuna e Gjakovës.

Tri rastet e konfirmuara me HIV janë të gjinisë mashkullore. Një rast është me nënshtetësi të huaj dhe është momentalisht duke vuajtur dënim në burg (është i diagnostikuar me HIV para 10 viteve jashtë vendit tonë dhe tani ARV e merre në KL. Infektive), i takon komunitetit LGBTQI, grup moshë 35-44 vjeç. Dy rastet tjera janë të gjinisë mashkullore, grup moshë 25-34 vjeç, Gjilan, komuniteti MSM dhe rasti tjetër nga Prishtina, rruga e transmissionit e panjohur.

### **Raportimi me SMSN :**

Rasti exitus dhe rasti nga komuna e Prishtinës janë të raportuara me SMSN nga ana e Klinikës Infektive. Rasti me nënshtetësi të huaj nuk ka pasur mundësi teknike të raportohet në SMSN. Rasti nga komuna e Gjilanit është dërguar për konfirmim nga ana e OJQ CSGD, është raportuar përmes MedLis nga mikrobiologjia por i njëjti nuk është lajmëruar akoma në KL. Infektive.

### **Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST), nëntor 2025**

Gjatë muajit nëntor 2025 janë raportuar gjithsej 29 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme.

Rastet e raportuara janë nga komunat: Ferizaj 16 raste, Prishtinë 3 raste, Gjakovë 2 raste, Prizren 2 raste, dhe me nga një rast komunat: Viti, Vushtrri, Gjilan, Istog, Malishevë dhe Lipjan. Sipas diagnozës: Chlamydia 14 raste, Condyloma 11, Gonorrhoeae 1 dhe HPV 3 raste. Sipas gjinisë: 21 (72%) i takojnë gjinisë femërore dhe 8 (28%) gjinisë mashkullore. Sipas grup moshës: 25-49 vjeç 21 raste (72%), 15-24 vjeç 7 raste (24%), dhe dy raste mbi 50 vjeç (4%).

### **Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C**

Gjatë muajit nëntor, nuk është raportuar asnjë rast me Hepatit akut B dhe Hepatit akut C.

# Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, nëntor 2025

Tabela 2.

Annex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave, nëntor 2025																																
SËMUNDJA	KOMUNA	Pneumonia/ARI	SARI	ILI	Diarrheaac	Variçella	InfluencaA	RSV	COVID-19	Sindroma meningjeale					Parotitis	Pertussis	Helmint me ushqim	Gastroenterokolitet	Tularemia	Rotavirus	Borelioz (Lyme Disease)	Adenovirus	Enterovirus	Leishmania	Cl.difficile	IST	HIV	TB	Giardiaz	Infeksionet streptokok sike të gr. A	Sëm.tjera ngjitëse	Totali
										Meningjit serosa	Meningjit purulent	Meningoencephalitis ac.	Meningitis meningococciae	Meningoencephalitis purulent																		
DEÇAN		2		118	59	4	1					1			3													1		2	191	
DRAGASH		4		9	6	2	1																							2	24	
DRENAS		2	1	7	9	4				1							1											2		27		
F. KOSOVË		5	3	88	70	8		6	1	1						1					1							1		187		
FERIZAJ		32	2	362	152	25		7	1	1						4										16	6		2	611		
GJAKOVË		12		191	1	11	1	1							2	41		1							1	2		4	19	4	291	
GJILAN		12		136	139	2		1								1										1	1			294		
GRAÇANICË																														0		
H. IELEZIT		0		39	24	8																								71		
ISTOG		5		111	63	2		1		1					4											1			1	189		
JUNIK		1		10	14	2									1															28		
KAÇANIK		4		54	32	5	1	1										1									2		102			
KAMENICË		0		298	76	0																							374			
KLINË		39	2	137	104	15	1	1		2					3	1											1		1	307		
KLLOKOT																														0		
LEPOSAVIQ																														0		
LIPJAN			2	48	29	1		3							1	2										1	1			88		
MALISHEVË			1	22	28	2	1	1							1											1	1			58		
MAMUSHË				10	18	9																								37		
MITROVICË		92	1	571	476	46	10	1		1					1	6													11	1216		
MITROVICË E VERIUT																														0		
N. BËRDË				18	12	0																								30		
OBLIQ			1	85	27	19		2																						134		
PARTESH																														0		
PEJË		22		688	276	49		1							2	14											2	1		6	1061	
PODUJEVË		32	1	183	116	11		2		1						1														348		
PRISHTINË		1109	9	1563	1247	186	11	20		7					1	9	10			1					1	3	1	8		2	4188	
PRIZREN		36		691	484	67	1	2							5					1						2		1	5	1296		
RAHOVEC			1	95	33	12		2												2										145		
RANILLUG																														0		
SHTËRPÇE																														0		
SHTIME		8		255	42	0											1											1		307		
SKËNDERAJ		20		50	32	13	2		1																					118		
SUHAREKË		4		320	183	12																								519		
VITI		1		130	84	4		2		1																1		1		224		
VUSHTRRI		8	1	47	58	18	1	1		1					5	1											1			33	175	
Z. POTOQ																														0		
ZVEÇAN																														0		
BURGU ***																														1		
PA ADRESË																														2		
TOTALI		1450	25	6336	3894	537	31	55	3	17	2	1	1	1	4	55	64	1	5	1	1	1	1	1	2	29	3	26	7	20	69	12643

\*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

\*\* Raste të importuara- Malarie, Mpox, Morbilli

\*\*\*Shtetas i huaj

### **3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRISË DHE SPITALET E PËRGJITHSHME, NËNTOR 2025**

Rastet e spitalizuara në numër më të madh nga sëmundjet ngjitëse janë raportuar nga pneumonitë dhe infeksionet virale të traktit respirator, të pasuara me diarë akute dhe gastroenterocolite. Vetëm një pjesë e këtyre rasteve kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit, ndërsa pjesa tjetër raportohet bazuar në diagnozën klinike (shih Tabela 3).

**Tabela 3. Rastet e spitalizuara me sëmundje ngjitëse në Klinikën Infektive, Pediatrië dhe spitalet e përgjithshme, nëntor 2025**

<b>Sëmundja</b>	<b>Rastet</b>
Pneumonia /ARI	165
SARI	25
Sindroma meningjeale	22
Helmimet me ushqim	8
Diarea akute dhe gastroenterocolite	111
Status febrilis	18
Exanthema	51
Mononucleosis	1
Erysipela	13
Herpes Zoster	1
<b>Gjithsej</b>	<b>415</b>

#### 4. EPIDEMITË E RAPORTUARA GJATË MUAJIT NËNTOR 2025

Gjatë muajit nëntor, nuk është raportuar asnjë epidemi.

#### 5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Për këtë periudhë, përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN) kanë raportuar 29 komuna ose 76.31% (29/38) e tyre. Komunat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Klokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok, komuna këto që gjithashtu nuk raportojnë as me kopje fizike.


**Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet shëndetësore përmes SMSN, nëntor 2025**

KOMUNA	KOPJE FIZIKE									SMSN												
	Sptali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucionet Private	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej	Sptali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucionet Private	QKTGJ	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej	
DEÇAN							94	36		130								45				45
DRAGASH							13	8		21								4				4
DRENAS							22			22								24	2			26
F. KOSOVË							24			24								52	25	74		151
FERIZAJ	8						51	241		300	1				3			15	7	1		27
GJAKOVË	2									2	28					56		158	68			310
GJILAN	9						289			298	18							19	38			75
GRAÇANICË										0												0
H. ILEZIT							64			64								4				4
ISTOG							29	103		132								32				32
JUNIK							2			2					2			14				16
KAÇANIK							86			86								4				4
KAMENICË							374			374								99	1			100
KLINË							266			266								7				7
KLLOKOT										0												0
LEPOSAVIQ										0												0
LIPJAN										0								72	1	5		78
MAJSHEVË										0								52				52
MAMUSHË							37			37								11				11
MITROVICË	641			9			305	177	18	1150								54				54
MITROVICË V.										0												0
N. BËRDË							30			30								3				3
OBILQ										0								94	27	11		132
PARTESH										0												0
PEJË	24					1	155	611	142	933	123				1			63				187
PODUEJË							335	2	13	350								67	7			74
PRISHTINË		128	674				231	1911	382	3326		30	3	7		8	4	3	582	3		640
PRIZREN	68						564	577	64	1289	45							30	113			188
RAHOVEC										0						18			125			143
RANILLUG										0												0
SHTËRPCE										0												0
SHTIME							62	215		277								26				26
SKËNDERAJ							65	24	7	96								19				19
SUHAREKË							209	225	47	481						6		98	4			108
VITI							219			219							37	12				49
VUSHTRRI			8	32			6	3	0	49	25			0			21	74	0			120
Z. POTOK										0												0
ZVEÇAN										0												0
Gjithsej	752	128	682	41	0	565	3545	3620	625	9958	240	30	3	7	0	94	62	1155	1000	94	2685	

Gjatë muajit nëntor 2025, përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN) janë raportuar gjithsej 2,685 raste me sëmundje ngjitëse dhe krahasuar me numrin e përgjithshëm të rasteve të raportuara (12,643) i shprehur në përqindje (21.23%). Gjatë muajit nëntor 2025 vërehet një tendencë në rënie prej 4.5% e numrit të rasteve të raportuara përmes SMSN krahasuar me muajin paraprak. (Tabela 4).

## 6. COVID-19

Gjatë muajit nëntor 2025, janë testuar gjithsej 485 mostra të dyshimta për COVID-19, prej të cilave janë konfirmuar 3 raste pozitive me SARS-CoV-2, me një shkallë të pozitivitetit prej 0.62%. Gjatë muajit nëntor 2025, nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me COVID-19. (Graf 1)



**Grafikoni 1. Numri i rasteve të testuara/konfirmuara me COVID-19, nëntor 2025**

Sipas komunave, 1 rast është raportuar nga komuna e Fushë Kosovës, 1 rast nga komuna e Ferizajit dhe 1 rast nga komuna e Skenderajit. Rastet e raportuara/konfirmuara me COVID-19 i takojnë grup-moshës: 10-19 (2 raste) dhe 0-9 vjeç (1 rast). Sipas gjinisë, të gjitha rastet i takojnë gjinisë mashkullore.

## 7. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME SËMUNDJE NGJITËSE NË RAJON DHE BOTË, NËNTOR 2025

### Situata epidemiologjike me patogjenë respiratorë

Aktiviteti i sëmundjeve respiratore në Rajonin European është rritur ndjeshëm. Në 15 vende, nivelet e infeksioneve akute respiratore dhe sëmundjes së ngjajshme me gripin kanë kaluar pragun sezonal. Influenca është tashmë e përhapur gjerësisht, me pozitivitet më të lartë tek fëmijët 5–14 vjeç dhe me rritje të hospitalizimeve tek personat mbi 65 vjeç. Virusi dominues mbetet A(H3), ndërsa SARS-CoV-2 vazhdon të bjerë dhe rastet e konfirmuara me RSV po rriten gradualisht, sidomos tek fëmijët nën 5 vjeç. Pozitiviteti i mostrave të testuara në qendrat sentinel për influencën ka arritur në 25%, ndërsa për SARS-CoV-2 ka rënë në 4% dhe për RSV mbetet rreth 3%. Në mbikëqyrjen epidemiologjike spitalore për SARI, pozitiviteti për Influcencën është rritur në 19%, duke konfirmuar qarkullimin dominant të A(H3). Vetëm Irlanda ka raportuar rritje të hospitalizimeve të lidhura me gripin. Vdekshmëria nga të gjitha shkaqet mbetet në nivele të pritshme. Karakterizimi i virusit tregon se sezoni vazhdon të dominohet nga A(H3), me disa klade të ndryshme në qarkullim. Varianti XFG është aktualisht linja mbizotëruese e SARS-CoV-2 në Evropë, ndërsa variantet e tjera janë në përqindje më të ulëta.

### Influenca A(H3N2)

Në Angli ka shpërthyer një valë e fortë gripi e shkaktuar nga sub-tipi i Influcencës A(H3N2), e cila po përhapet me shpejtësi të lartë sidomos në institucionet arsimore. Për shkak të numrit të madh të rasteve me simptoma të gripit në mesin e nxënësve dhe stafit, disa shkolla kanë marrë vendim për mbyllje të përkohshme dhe dezinfektim të ambienteve për të frenuar përhapjen. Institucionet shëndetësore, përfshirë UKHSA dhe NHS, raportojnë se ky sezon i gripit ka filluar më herët dhe më fuqishëm se vitet e kaluara, me një rritje të theksuar të pranimitimeve në spitale. Sub-tipi H3N2 është identifikuar si një variant “shumë agresiv” dhe potencialisht më i rrezikshëm, duke shkaktuar simptoma më të rënda tek fëmijët, të moshuarit dhe personat me sëmundje kronike. Autoritetet po këshillojnë popullatën të rikthejë disa masa parandaluese si mbajtja e maskës kur janë të sëmurë, larja e rregullt e duarve dhe ajrosja e mjediseve, ndërsa theksojnë rëndësinë e vaksinimit si mjete kryesor mbrojtës. Situata po monitorohet nga afër për shkak të rrezikut të mbingarkesës së shërbimeve shëndetësore gjatë periudhës së dimrit.

### Influenca A (H5N2)

Në nëntor 2025 u konfirmua rasti i dytë njerëzor me Influcencë Aviane A(H5N2) në Meksikë dhe globalisht. Rasti i ri, një grua e re pa sëmundje të mëparshme, kishte gjasa të ishte ekspozuar ndaj shpendëve dhe një qeni të infektuar pranë banesës së saj në Mexico City. Rasti i parë ishte raportuar në vitin 2024 tek një 59-vjeçar me sëmundje të tjera shoqëruese, pa ekspozim të njohur ndaj shpendëve. Hetimet epidemiologjike nuk kanë identifikuar raste të tjera dhe nuk ka prova për transmetim nga njeriu te njeriu. Analiza gjenetike e virusit të rastit të dytë tregon se ai i përket kladës 2.3.4.4b dhe ka karakteristika të një virusi shumë patogjen. Virusi paraqet dallime të mëdha nga shtamet e A(H5N2) të vitit 2024 dhe lidhet më ngushtë me viruse A(H5N1) të së njëjtës klade. Edhe pse nuk janë identifikuar mutacione të njohura për rritje të rrezikut zoonotik, analiza e thelluar e sekuencave zbuloi variante të rralla që mund të rrisin aftësinë e shumimit në qeliza të gjitarëve. Infeksioni lidhet kryesisht me kontakt të drejtpërdrejtë me shpendë ose kafshë të tjera të infektuara. Zbatimi i masave mbrojtëse për personat e ekspozuar ndaj kafshëve është thelbësor për uljen e rrezikut. Duke qenë se rastet njerëzore mbeten shumë të rralla dhe nuk ka transmetim të qëndrueshëm mes njerëzve, rreziku për popullatën e përgjithshme të BE/ZEE vlerësohet i ulët. ECDC vazhdon mbikëqyrjen e Influcencës Aviane në bashkëpunim me EFSA-n dhe laboratorin referencë të BE-së, duke ndjekur ndryshimet virologjike dhe epidemiologjike dhe duke publikuar përditësime periodike.

## Hepatiti A

Gjatë vitit 2025, disa vende të BE-së – kryesisht Austria, Çekia, Hungaria dhe Sllovakia – kanë raportuar një rritje të ndjeshme të rasteve të hepatitit A të sub-gjenotipit IB, me mbi 6 000 raste të kumuluar deri në fund të tetorit dhe 39 fatalitete. Shpërthimi mbetet aktiv dhe transmetimi vazhdon në komunitet. Vendet më të prekura janë Çekia dhe Sllovakia, me numrin më të lartë të rasteve dhe vdekshmërisë. Modelet epidemiologjike ndryshojnë sipas vendit: në Austri dhe Çeki dominojnë rastet te të rriturit, shpesh të lidhura me personat që përfshijnë mungesë strehimi dhe përdorues të drogave, ndërsa në Hungari dhe Sllovakia ka përqendrim më të madh rastesh te komunitetet Rome dhe fëmijët që jetojnë në kushte të dobëta higjieno-sanitare. Asnjë vend nuk ka raportuar indikacione për transmetim ushqimor. Nga aspekti molekular, vazhdon qarkullimi i dy klasterëve të ngjashëm të sub-gjenotipit IB: Klasteri A dhe Klasteri B, të cilët dallojnë vetëm me një ndryshim nukleotidik, duke sugjeruar transmetim të vazhdueshëm brenda vendit dhe lidhje epidemiologjike midis komuniteteve të ekspozuara. Deri më tani raste me Hepatit A kanë raportuar: Austria: 216 raste deri në fund të tetorit; përqendrim në Vjenë. Grupet kryesore të prekura – persona pa strehë, përdorues drogash, raste të lidhura me kontakte të ngushta dhe disa me transmetim seksual. Katër fatalitete të raportuara, Çekia: përhapje e shpejtë me 2 310 raste dhe 27 vdekje; incidencë e lartë në Pragë dhe Moravia-Silesia. 17 shpërthime të identifikuar, me 80% të rasteve të hospitalizuara, duke reflektuar barrë të konsiderueshme klinike, Hungaria: 1 548 raste; incidencë më e lartë tek fëmijët 3–9 vjeç. Identifikohet rritje te komunitetet Rome dhe raste të pakta te njerëzit pa strehë. Masa të gjera ndërgjegjësimi, vaksina PEP për kontaktet dhe komunikim publik i përforcuar, Sllovakia: 2 482 raste gjatë 2025; situata në përmirësim krahasuar me pikat kulmore të 2023–2024, por transmetimi vazhdon në komunitetet Rome dhe në popullata me kushte të dobëta sanitare. Katër vdekje në 2025. Gjithashtu janë identifikuar raste të importuara ose të lidhura me udhëtime në Gjermani, Suedi dhe MB,

Transmetimi kryesor është person-në-person, i favorizuar nga kushtet e dobëta higjieno-sanitare, grumbullimi i rasteve në ambiente me densitet të lartë social, përdorimi i drogave dhe bashkësitë e cenushme. Rreziku vlerësohet i moderuar i lartë për grupet vulnerabel dhe i ulët-moderuar për popullatën e përgjithshme me akses në shërbime shëndetësore. Rreziku mbetet shumë i ulët për individët e vaksinuar.

## Chikungunya

Deri më 3 dhjetor 2025, vetëm dy vende të Evropës – Franca dhe Italia – kanë raportuar raste të Chikungunya-s, me 788 raste në Francë dhe 384 në Itali. Këtë javë nuk janë raportuar raste të reja dhe të dy vendet kanë korrigjuar shifrat pas rishikimit epidemiologjik, duke eliminuar disa raste dhe klasterë. Franca ka aktualisht 78 klasterë të regjistruar, prej të cilëve tre mbeten aktivë, me klasterin më të madh në Antibes. Italia ka gjashtë klasterë të konfirmuar, dy ende aktivë, me klasterin më të madh që shtrihet në disa bashki të rajonit të Modenës. Për shkak të kushteve të pafavorshme sezonale për transmetimin nga vektorët, pritet që numri i rasteve të mos rritet më tej.

## MERS-CoV

Më 3 dhjetor 2025, Franca raportoi dy raste të importuara të MERS-CoV me udhëtim në Gadishullin Arabik. Të dy rastet ishin pjesë e të njëjtit grup udhëtimi dhe ishin simptomatikë. Autoritetet franceze identifikuan dhe monitoruan kontaktet e ngushta dhe kontaktet me rrezik të lartë. Nuk janë raportuar raste sekondare deri tani. Që nga fillimi i vitit 2025, në Arabinë Saudite janë raportuar 12 raste, tre me fatalitet. Rreziku për transmetim të qëndrueshëm në BE/ZEE mbetet shumë i ulët. Masat përfshijnë testimin e personave simptomatikë, izolimin e rasteve të dyshuara dhe respektimin e protokolleve të rrepta infektive në spitale. Informimi i udhëtarëve për kontaktet e mundshme me deve dhe produktet e papërpunuara mbetet i rëndësishëm. Qytetarët e BE/ZEE që udhëtojnë ose kthehen nga zonat e prekura këshillohen të kërkojnë kujdes mjekësor nëse shfaqin simptoma.

## **8. REKOMANDIMET**

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave në kohë reale, të dhëna kualitative dhe pasqyrë reale të situatës epidemiologjike për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

---

***INSITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË***

***PUBLIKE TË KOSOVËS***

***Departamenti i Epidemiologjisë***

***Adresa: R. Instituti Shëndetësor Nr. 12, Prishtinë 10000***

***WebFaqe: <http://www.ikshpk.rks-gov.net>***

***E-mail: [QOE.IKSHP@rks-gov.net](mailto:QOE.IKSHP@rks-gov.net)***

***Telefoni+38338 541432***

---